



eptisa

PROJECT IMPLEMENTED BY JV NTU/EPTISA



WORLD BANK GROUP

FINANCED BY GOA AND COFINANCED BY WB

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

Projekti i Mirëmbajtjes dhe Sigurisë Rrugore Bazuar në Rezultate (RRMSP)

Hua e Bankës Botërore Nr. 8489-AL

Nr. i Kontratës: CS 02

Shërbime Konsulence

për

Asistencë Teknike për Sigurinë Rrugore

Raport i Ndërmjetëm Nr.6 Komponenti 1

D-1.6

Versioni Paraprak

Prill 2021



TË DHËNAT IDENTIFIKUESE TË PROJEKTIT

Emri i Projektit:	Shërbime Konsulente për Asistencë Teknike për Sigurinë Rrugore për Projektin e Mirëmbajtjes dhe Sigurisë Rrugore Bazuar në Rezultate (RRMSP) për Rrjetin Rrugor Kombëtar
Numri referues i Kontratës së Projektit:	WB2400-05/17, IBRD 84890TF 14761, P132982, CS 2, 8489 – AL
Vendi:	Shqipëri
Konsulenti:	JV NTU InternationalA/S / EPTISA Servicios De Ingenieria S.L.
Adresa:	Vestre Havnepromenade 5, 4. Floor DK-9000 Aalborg Denmark
Telefon:	+45 99 30 0000
Fax:	+45 99 30 0001
Personi Kontakti:	Dritan Dibra – Menaxheri i Projektit, Eptisa
E-mail:	ddibra@eptisa.com
Data e Raportit:	Prill 2021
Autorët e raportit:	Francisco Reina Barranco, K-2 Specialist i Analizës së Sigurisë Rosemary Rouse, K-3 Specialist i Monitorimit dhe Vlerësimit <i>Me të dhëna nga : Stelios Efstathiadis, K-1 Lider i Grupit</i>

SQARIM

Ky raport (përfshirë shtojcat dhe materialet bashkëlidhëse) është përgatitur ekskluzivisht për përdorim nga Qeveria Shqiptare/ Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Banka Botërore, dhe vetëm për qëllimin për të cilin është hartuar. Përveç rasteve kur BO NTU/EPTISA jep miratimin e saj me shkrim, asnjë pjesë e këtij raporti nuk mund të kopjohet, riprodhohet apo të përdoret nga palë të treta. BO NTU/EPTISA nuk mban asnjë përgjegjësi nëse ky raport përdoret për qëllime të tjera nga i cili është menduar, apo përdoret nga palë të treta.

KONTROLI DOKUMENTEVE

Numri i referencës së Kontratës së Projektit:	WB2400-05/17, IBRD 84890TF 14761, P132982, CS 2, 8489 – AL Shërbime Konsulence për Asistencë Teknike për Sigurinë Rrugore për Projektin e Mirëmbajtjes dhe Sigurisë Rrugore Bazuar në Rezultate (RRMSP)
Shteti	Shqipëri
Date	30.04.2021
Versioni	N°01

Versioni	Datë	Përgatiti	Rishikuar
N°01	30.04.2021	Francisco Reina Barranco / Rosemary Rouse	Dragan Kostadinov Drejtor Projekti

PËRMBLEDHJE

Ky dokument përbën Raportin Ndërmjetëm Nr. 6-të Komponentit 1 për Asistencën Teknike të Sigurisë Rrugore (AT) nën Projektin e Mirëmbajtjes dhe Sigurisë Rrugore të Bazuar në Rezultate (RRSMP).

Sipas Termave të Referencës (ToR), Komponenti 1 ka të bëjë me mbështetjen e Departamentit të Sigurisë Rrugore (MIE) si Zyra Kryesore (Agjensia) dhe si Sekretariati i Komitetit Ndërministror të Sigurisë Rrugore (IMRSC) duke ndimuar në zhvillimin e kapaciteteve dhe procedurave të brendshme për të kryer funksionet institucionale mbi bazën e parimit "të bazuara në rezultate".

Ky raport synon të paraqesë rezultatet e aktiviteteve dhe detyrave të kryera gjatë periudhës Shkurt-Prill 2021 në lidhje me Komponentin 1, si dhe aktivitetet e pritshme për t'u zbatuar në tremujorin vijues Maj - Qershor 2021.

Aktivitetet dhe detyrat e mëposhtme janë zbatuar gjatë tremujorit të fundit:

Aktiviteti 1.3 – Mbështetje e Zyrës Qendrore lidhur me "Legjislacionin"

- Detyra 1.3.3: Raporti i Seminarit për Zhvillimin e Kapaciteteve që kanë të bëjnë me procesin e Legjislacionit;

Aktiviteti 1.5: Mbështetje Zyrës Qendrore për "Kërkimin dhe Zhvillimin";

- Detyra 1.5.2: Identifikimi i kapaciteteve të brendshme për R&D në Shqipëri;

Aktiviteti 1.6: Përgatitja dhe kryerja e trajnimeve / seminareve për çështje të caktuara;

- Detyra 1.6.1: Përgatitja dhe zhvillimi i trajnimeve / seminareve për çështje të caktuara;

Aktiviteti 1.7: Mbështetje Zyrës Drejtuese për "Monitorimin dhe Vlerësimin";

- Detyra 1.7.1.d: Udhëzuesit Përfundimtare lidhur me anketimin e popullsisë;
- Detyra 1.7.1 e: Identifikimi i konsulentëve vendas dhe të huaj lidhur me realizimin e anketimeve dhe sigurimin e të dhënave të sigurisë rrugore;
- Detyra 1.7.2: Raporti i Seminarit për Zhvillimin e Kapaciteteve lidhur me monitorimin dhe vlerësimin;
- Detyra 1.7.3: Raporti i Rishikimit të Sistemit të Monitorimit dhe Vlerësimit;

Aktivitetet dhe detyrat e mëposhtme janë ende në vazhdim e sipër dhe do të zgjasin deri në fund të asistencës teknike;

Aktiviteti 1.5: Mbështetje Zyrës Qendrore për "Kërkimin dhe Zhvillimin";

- Detyra 1.5.3: Propozimi i Planit të R&D;

Aktiviteti 1.6: Përgatitja dhe kryerja e trajnimeve / seminareve për çështje të caktuara;

- Detyra 1.6.2: Përgatitja dhe zhvillimi i ndihmës në praktikë për krijimin e një njësie Drejtuese të Fuqishme;

Aktiviteti 1.7: Mbështetje lidhur me Zyrën Qendrore për “Monitorimin dhe Vlerësimin”;

- Detyra 1.7.1f: Hartimi dhe mbështetja e sistemeve M&E të projektit për korridoret dhe zonat me rrezik të lartë (dhe kontrolli);
- Detyra 1.7.1g: Raporti i Rishikimit të treguesve të rezultateve të Projektit;
- Detyra 1.7.4: Përgatitja e një programi kombëtar dhe udhëzimet për një sistem M&E në të gjithë rrjetin;

Shtojcat bashkëlidhur këtij raporti përmbajnë detajet e rezultateve nga detyrat e Aktivitetit 1 të zbatuara gjatë kësaj periudhe.

PËRMBAJTJA

1. Hyrje	9
1.1 Përshkrim i Projektit	9
1.2 Zbatimi	10
2. Aktivitetet	11
2.1 Hyrje.....	11
2.2 <i>Detyra 1.3.3: Raporti i seminarit lidhur me legjislacionin</i>	11
2.3 <i>Detyra 1.5.2: Identifikimi I kapaciteteve R&D të Shqipërisë</i>	12
2.4 <i>Detyra 1.6.1: Përgatitja dhe realizimi i trajnimit/seminarit lidhur me çështje të caktuara</i>	12
2.5 <i>Detyra 1.7.1d: Udhëzuesit lidhur me intervistimin</i>	14
2.6 <i>Detyra 1.7.1e: Identifikoni konsulentet vendas ndërkombëtarë që mund të realizojnë mbledhjen e të dhënave të vrojtimit teknik dhe social</i>	14
2.7 <i>Detyra 1.7.2: Raporti i Seminarit të Zhvillimit të Kapaciteteve lidhur me monitorimin dhe vlerësimin e sigurisë rrugore</i>	14
2.8 <i>Detyra 1.7.3: Raporti i Vlerësimit dhe monitorimit</i>	16
2.9 Vlerësimi i trajnimeve/seminareve sipas detyrave 1.3.3 dhe 1.6.1	16
3. Plani Punës	19
3.1 Ndjekja e komponentëve të aktivitetit	19
3.2 Plani i detajuar i aktiviteteve për tremujorin e ardhshëm	20

1. Hyrje

Ky dokument përbën Raportin e 6-të të Përkohshëm të Komponentit 1 për Asistencën Teknike të Sigurisë Rrugore (AT) nën Projektin e Mirëmbajtjes dhe Sigurisë Rrugore të Bazuar në Rezultate (RRMSP).

Ky raport synon të paraqesë rezultatet e aktiviteteve dhe detyrave të kryera gjatë periudhës Shkurt-Prill 2021 në lidhje me Komponentin 1, si dhe aktivitetet e pritshme për t'u zbatuar në tremujorin vijues Maj - Qershor 2021.

1.1 Përshkrim i Projektit

Sipas Termave të Referencës (ToR), Komponenti 1 ka të bëjë me mbështetjen e Departamentit të Sigurisë Rrugore (MIE) si Zyra Kryesore (Agjensia) dhe si Sekretariati i Komitetit Ndërmintor të Sigurisë Rrugore (IMRSC) duke zhvilluar kapacitete dhe procedura të brendshme për të kryer funksione institucionale "Të bazuara në Rezultate" me këto objektiva:

- *Mbështet Njësinë Drejtuese (Departamenti i Sigurisë Rrugore - MIE) duke zhvilluar kapacitete dhe procedura të brendshme për të kryer funksione institucionale "Të bazuara në Rezultate": "Kordinimi" si Sekretariati për IMRSC; "Legjislacioni" i përqendruar në përmirësimin dhe përditësimin e rregullave të sigurisë rrugore dhe akteve nënligjore kryesore; "Financimi dhe Alokimi i Fondeve" për të paraqitur të dhëna statistikore, përlllogaritjet ekonomike dhe përfitimet për mbështetjen buxhetore dhe nevojat për financimin e ndërhyrjeve dhe masave të tjera të sigurisë rrugore; "Kërkim dhe Zhvillim" për të deleguar dhe ndjekur këtë funksion tek palët e treta (p.sh. Institutet e Trafikut ose sektori privat), "Monitorimi dhe Vlerësimi" për të qenë në gjendje të monitorojë dhe vlerësojë rezultatet dhe nëse ka nevojë për të deleguar një pjesë të këtij funksioni te pala e tretë organizatat (p.sh. Instituti i Trafikut ose sektori privat).*
- *Mbështet Njësinë Drejtuese si teknikisht ashtu edhe administrativisht në detyrën multi-disiplinore në një spektër të gjerë që përfshin rrugët, automjetet dhe përdoruesit e rrugës.*
- *Siguron trajnimin e duhur dhe mbështetjen dhe mësimin në praktikë lidhur me krijimin e një Njësie Drejtuese.*

Rezultatet kryesore që do të arrihen me zbatimin e aktiviteteve dhe detyrave të Komponentit 1 janë si më poshtë:

- a) Zhvillimi i kapaciteteve dhe procedurave të brendshme të Njësise Drejtuese për të kryer funksione institucionale "Bazuar në Rezultate"*
- b) Mbështetja për Zyrën Kryesore teknikisht dhe administrativ ofrohet në detyra multi-disiplinore në të gjithë spektrin si në atë të rrugëve, automjeteve dhe përdoruesve të rrugës.*
- b) Gjithashtu është ofruar trajnim dhe mbështetje në praktike për krijimin e një Njësie Drejtuese të fuqishme.*

1.2 Zbatimi

Raporti fillestar përshkruan qasjen që Konsulenti synon të ndjekë gjatë kryerjes së aktiviteteve të Komponentit 1 të AT. Qasja e përshkruar bazohet në ToR dhe bazohet në metodologjinë e paraqitur në ofertën teknike sipas rezultateve paraprake dhe nevojave aktuale të përfituesve të ndryshëm.

Ndarja në seksione korrespondon gjerësisht me listën e aktiviteteve të përfshira në ToR:

1. Mbështetje Njësisë Drejtuese për "Kordinimin", si Sekretariati për IMRSC;
2. Hapat që duhet të ndiqen për themelimin e Sekretariatit;
3. Mbështetje Njësisë Drejtuese për "Legjislacionin";
4. Mbështetje Njësisë Drejtuese për "Financimin dhe Alokimin e Burimeve";
5. Mbështetje Njësisë Drejtuese për "Kërkimin dhe Zhvillimin";
6. Përgatitja dhe kryerja e trajnimeve / seminareve në disa drejtime;
7. Mbështetje lidhur me Zyrën Qendrore për "Monitorimin dhe Vlerësimin".

2. Aktivitetet

2.1 Hyrje

Bazuar në raportin fillestar gjatë tre muajve të fundit janë kryer aktivitetet dhe detyrat e mëposhtme

Aktiviteti 1.3: Mbështetje Njesisë Drejtuese lidhur me “Legjislacionin”

- *Detyra 1.3.3: Zhvillimi i seminarit lidhur me procesin e legjislacionit*

Aktiviteti 1.5: Mbështetje e Njesisë Drejtuese lidhur me “Kërkim Zhvillimin”

- *Detyra 1.5.2: Identifikimi i kapaciteteve të brendshme lidhur me kërkim&zhvillimin në Shqipëri*

Aktiviteti 1.6: Përgatitja dhe kryerja e trajnimeve / seminareve në zonat e synuara

- *Detyra 1.6.1: Përgatitja dhe zhvillimi i trajnimeve /seminarve në drejtime të caktuara*

Aktiviteti 1.7: Mbështetje Njesisë Drejtuese për “Monitorimin dhe Vlerësimin”

- *Detyra 1.7.1.d: Udhëzimet Përfundimtare për Anketat Bazë të Qëndrimit të Komunitetit*
- *Detyra 1.7.1.e: Identifikoni konsulentët vendas dhe ndërkombëtarë që mund të realizojnë vrojtime teknike dhe të aspekteve sociale.*
- *Detyra 1.7.2: Raporti i Seminarit për Zhvillimin e Kapaciteteve lidhur me monitorimin dhe vlerësimin*
- *Detyra 1.7.3: Raporti i Rishikimit të Sistemit të Monitorimit dhe Vlerësimit*

2.2 *Detyra 1.3.3: Raporti i seminarit lidhur me legjislacionin*

Një seminar trajnues 1-ditor për të paraqitur analizën e mangësive të legjislacionit dhe procedurat e sugjeruara për ndjekjen dhe përditësimin tij u krye në 29 Mars 2021.

Seminari u krye nga Francisco Reina Barranco, Specialist i Analizës së Sigurisë K-2, duke u bazuar në një qasje pragmatike.

Aktorët kryesorë shqiptarë të sigurisë rrugore u ftuan të marrin pjesë në seminar.

Përmbledhja e këtij seminari ishte si vijon:

Moduli 1: Instrumentet Ligjore në sigurinë rrugore

Përshkrimi i sistemit ligjor të Sigurisë Rrugore

- Instrumentet ligjore për sigurinë rrugore;
- Rregulloret ndërkombëtare të sigurisë rrugore;
- Kuadri ligjor i BE-së për sigurinë rrugore.

Moduli 2: Sistemi ligjor i sigurisë në Shqipëri

- *Përshkrimi i sistemit aktual ligjor të sigurisë rrugore në Shqipëri;*
- *Kuadri ligjor i sigurisë rrugore;*
- *Harmonizimi i rregullores shqiptare me legjislacionin e BE-së;*
- *Rezultatet e analizës së diferencave të legjislacionit.*

Moduli 3: Proçedurat e përditësimit të legjislacionit

Përshkrimi i sistemit të sigurisë rrugore në Shqipëri

- Proçesi legjislativ në Shqipëri;
- Proçedura për ndjekjen dhe përditësimin e legjislacionit të sigurisë rrugore.

Vlerësimi i seminarit është dhënë në Shtojcën 6.

2.3 Detyra 1.5.2: Identifikimi i kapaciteteve R&D të Shqipërisë

Një vlerësim i aftësive dhe nevojave për trajnim u krye për të identifikuar kapacitetet e brendshme për Kërkim&Zhvillim në Shqipëri

Kapacitetet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë - Departamenti i Sigurisë Rrugore dhe palët e tjera të interesit të sigurisë rrugore u vlerësuan.

Vlerësimi i kapaciteteve të mëposhtme brenda funksionit Kërkim&Zhvillimit u përqendrua veçanërisht:

- Garantimi i kapaciteteve për kërkimin dhe menaxhimin e sigurisë rrugore;
- Kontraktimi i organizatave kërkimore të sigurisë rrugore ndërsa aktiviteti i sigurisë rrugore rritet;
- Zhvillimi i programeve kërkimore të sigurisë rrugore dhe krijimi i partneriteteve për atë qëllim;
- Kryerja e rishikimit vjetor të nevojave për programet kërkimore të sigurisë rrugore;
- Caktimi i buxheteve specifike vjetore për hulumtimin e sigurisë rrugore;
- Zhvillimi i mjeteve të trajnimit dhe transferimit të njohurive për Kërkim & Zhvillim;
- etj.

2.4 Detyra 1.6.1: Përgatitja dhe realizimi i trajnimit/seminarit lidhur me çështje të caktuara

Dy ditë seminar u kryen më 25 dhe 29 Mars 2021 rreth menaxhimit të sigurisë rrugore, financimit dhe alokimit të burimeve.

Të dy seminarët u mbajtën nga Francisco Reina Barranco, Specialist i Analizës së Sigurisë K-2, duke ndjekur një qasje pragmatike.

Institucionet kryesorë të sigurisë rrugore u ftuan të marrin pjesë në seminar.

Përmbledhja e këtyre dy diteve seminar është si më poshtë:

Seminar lidhur me Menaxhimin e Sigurisë Rrugore (25 Mars 2021)

Moduli 1: Problemi i Sigurisë rrugore

Një hyrje e shkurtër e sigurisë rrugore në nivel lokal dhe global

- Faktet, trendet dhe sfidat e sigurisë rrugore

Moduli 2: Synimet dhe nismat e Sigurisë Rrugore

Prezantimi i strategjive globale të sigurisë rrugore

- *Plani Global për Dekadën e Veprimit lidhur me Sigurinë Rrugore 2011-2020*
- *Qëllimet e UN për Zhvillimin e Qëndrueshëm*

Moduli 3: Politikat e Sigurisë Rrugore

- Vizioni Zero
- Siguria e Qëndrueshme
- Politika e BE-së për sigurinë rrugore

Moduli 4: Qasja e Sistemit të Sigurt

Hyrje e shkurtër në qasjen e Sistemit të Sigurt

- Çfarë është sistemi i sigurt?
- Qasja e Sistemit të Sigurt
- Parimet e Sistemit të Sigurt
- Elementet e Sistemit të Sigurt

Moduli 5: Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë Rrugore: menaxhimi mbi bazën e rezultateve

Përshkrimi i një sistemi të menaxhimit të sigurisë rrugore të bazuar në rezultate.

- Drejtimi i sigurisë rrugore
- Kuadri i menaxhimit të sigurisë rrugore
- Sistemi i menaxhimit të sigurisë rrugore i bazuar në rezultate
- Projektet bazuar në filozofinë e Sistemit të Sigurt

Moduli 6: Sistemi shqiptar i menaxhimit të sigurisë rrugore

Përshkrimi i sistemit aktual të menaxhimit të sigurisë rrugore në Shqipëri

- Kuadri institucional i sigurisë rrugore në Shqipëri
- Rishikimi i kapacitetit të menaxhimit të sigurisë rrugore

Seminar bi Fondet dhe alokimin e burimeve (29 Mars 2021)

Moduli 1: Synimet dhe planet e Sigurisë Rrugore

Hyrje e shkurtër në lidhje me synimet dhe planet e sigurisë rrugore

- Vlerësimi i problemeve të sigurisë
- Vendosja e synimeve
- Planet dhe implementimi i investimeve
- Treguesit e performancës së sigurisë

Moduli 2: Financimi i sigurisë rrugore

Hyrje e shkurtër në lidhje me burimet e financimit për sigurinë rrugore

- Burimet e financimit

Moduli 3: Alokimi i burimeve të sigurisë rrugore

Hyrje e shkurtër në lidhje me alokimin e burimeve për sigurinë rrugore

- Analiza e kostos dhe përfitimit
- Vlerësimi me shumë kritere

Vlerësimi i seminarit është përfshirë në Shtojcën 6.

2.5 Detyra 1.7.1d: Udhëzuesit lidhur me intervistimin

U përgatitën udhëzuesit për kryerjen e sondazheve të marketingut social lidhur me informacionin bazë mbi njohuritë e komunitetit, qëndrimet dhe sjelljet e vetë-raportuara rreth çështjeve kryesore të sigurisë rrugore si dhe kryerjen e vrojtimit në rrugë. Janë dorëzuar punëdhënësit udhëzuesit për kryerjen e sondazheve dhe përpunimit të të dhënave për raportimin tremujor dhe vjetor (versioni paraprak).

2.6 Detyra 1.7.1e: Identifikoni konsulentet vendas ndërkombëtarë që mund të realizojnë mbledhjen e të dhënave të vrojtimit teknik dhe social

Është bërë një vlerësim i aftësisë aktuale teknike të konsulentëve të huaj dhe kombëtarë lidhur me realizimin e vrojtimit teknik dhe social. Është përgatitur një raport lidhur me listën e kompanive që ofrojnë këtë shërbim.

2.7 Detyra 1.7.2: Raporti i Seminarit të Zhvillimit të Kapaciteteve lidhur me monitorimin dhe vlerësimin e sigurisë rrugore

Seminari dy-ditor, me pjesëmarrjen në sallë të ekspertëve, e propozuar fillimisht u riorganizua dhe u krye në internet në katër module në distancë. Seminari u mbajt në datat 9, 10 dhe 24 Mars 2021. Seminari u mbajt nga Rosemary Rouse Specialiste e Vlerësimit dhe Specialist i Analizës së Sigurisë Edmond Alite NK-1.

Për të angazhuar pjesëmarrësit, seancat e seminarit përfshinë një pyetësor për një rast studimor dhe u punuan katër ushtrime të paraqitura si shembuj.

Aktorët kryesorë shqiptarë të sigurisë rrugore u ftuan të marrin pjesë në seminar.

Përmbledhja e këtij seminari/trajnimi ishte si vijon:

Moduli 1: Monitorimi dhe Vlerësimi i Sigurisë Rrugore – Bazat

Hyrje në monitorimin dhe vlerësimin

- Qëllimet, objektivat dhe rezultatet e të nxënësve të seminarit;
- Parimet dhe proceset për monitorimin dhe vlerësimin;
- Monitorimi dhe vlerësimi ndodhin brenda qasjes së Sistemit të Sigurt.

Moduli 2: Monitorimi dhe Vlerësimi deri në vitin 2030

Prezantimi i monitorimit brenda një kornize strategjike

- Objektivat e performancës globale të sigurisë rrugore të UN 2030

- Të dhënat aktuale 'fillestare' të paraqitura nga GOA në OBSH për Raportin e Statusit Global 2018 për Sigurinë Rrugore;
- Monitorimi brenda Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Rrugore;
- Monitorimi në veprim, nivelet e ndërmjetme dhe përfundimtare të rezultateve;
- Rëndësia e komunikimit dhe shfrytëzimit të rezultateve të monitorimit për përditësimin e politikës, strategjisë, alokimit të burimeve dhe shpërndarjes së programit

Moduli 3: Treguesit e Performancës së Sigurisë

Prezantimi i rolit dhe funksionit të Treguesve të Performancës së Sigurisë

- Përkufizimet e SPI, nevoja që ato të lidhen kauzalisht me fatalitetin dhe rrezikun serioz të lëndimit;
- Rëndësia e mbledhjes së të dhënave në mënyrë uniforme dhe analizave të qëndrueshme me kohë;
- Rëndësia e të dhënave fillestare;
- Rëndësia e SPI-ve 'të realizueshme' për të cilat mund të mblidhen të dhëna;
- Rëndësia e përdorimit të gjetjeve kryesore për të komunikuar rezultatet dhe avokuar për sigurinë rrugore.

Moduli 4: Hyrje në Vlerësimin e Sigurisë Rrugore

Hyrje në vlerësimin e sigurisë rrugore

Hyrje e shkurtër në vlerësimin e sigurisë rrugore

- Përkufizimi i vlerësimit dhe mënyra se si ndryshon nga dhe plotëson monitorimin;
- Gjashtë hapa në procesin e vlerësimit;
- Objektivat e vlerësimit SMART;
- Fazat e programit të vlerësimit - formimi, procesi, ndikimi dhe rezultati;
- Hartime të zakonshme të hulumtimit të sigurisë rrugore - vlerësimi 'para dhe pas' (i quajtur ndryshe 'para dhe pas'), vlerësimi i 'rastit dhe kontrollit' dhe serive kohore;
- Janë identifikuar dhe diskutuar arsyet tipike për dështimin e programeve në demonstrimin e rezultateve.

Vlerësimi i seminarit

Pas përfundimit të secilës seancë, pjesëmarrësve u kërkua të plotësonin një vlerësim të shkurtër nëpërmjet internetit. Përmbajtja e Seminarit M&E u vlerësua 'shumë e rëndësishme' nga 69% e pjesëmarrësve (vlerësojeni atë 5 në shkallën nga 1 në 5) me një vlerësim të mëtejshëm 31% të përmbajtjes si 'relevante' (vlerësoni atë 4 ose 3 në këtë shkallë).

Dokumenti që përmban analizën dhe rekomandimet e sugjeruara është bashkangjitur si një Shtojcë e këtij raporti (Shtojca 4).

2.8 Detyra 1.7.3: Raporti i Vlerësimit dhe monitorimit

U prezantua rëndësia e krijimit të një sistemi monitorimi dhe vlerësimi që pasqyron praktikën më të mirë ndërkombëtare por që është gjithashtu e realizueshme dhe me kosto efektive për tu zbatuar brenda burimeve aktuale. Situata dhe praktika aktuale në Shqipëri në lidhje me zbatimin e sondazheve të të dhënave u theksua dhe vlerësua në krahasim me praktikën ndërkombëtare.

U percaktuan konkluzionet në lidhje me sistemin e tanishëm të monitorimit dhe vlerësimit për zonat me rrezik të lartë në Shqipëri. Gjithashtu u identifikuan fushat kryesore për t'u përmirësuar.

Dokumenti që përmban analizën dhe rekomandimet e sugjeruara është bashkangjitur si një Shtojcë e këtij raporti (Shtojca 5).

2.9 Vlerësimi i trajnimeve/seminareve sipas detyrave 1.3.3 dhe 1.6.1


Mbi 90% e pjesëmarrësve në seancat e trajnimit plotësuan formularin e vlerësimit të përgatitur nga ekipi i ekspertëve . Formulari i vlerësimit u shpërnda në secilën sesion trajnimi. Për një analizë më të detajuar rezultatet e vlerësimit janë paraqitur të përmbledhura dhe sipas temave të trajnimit.

Vlerësimi synonte të vlerësonte pritshmëritë e pjesëmarrësve me seancat e trajnimit, perceptimet e tyre mbi dobini e trajnimeve në praktike , rëndësinë e secilës temë të trajtuar nga seancat e trajnimit dhe cilësinë e aspekteve organizative.

Formulari i vlerësimit i'u vu ne dispozicion pjesëmarrësve përmes një lidhje në internet, ishte anonim dhe pjesëmarrësit u informuan për anonimitetin dhe konfidencialitetin e përgjigjeve të tyre.

Seancat e trajnimit u vlerësuan shumë nga pjesëmarrësit dhe u konsideruan shumë të dobishme në punën e tyre të përditshme. Sipas Grafikut 1, seancat e trajnimit u vlerësuan 9.4, mesatarisht, në një shkallë nga 1 në 10, rreth dy të tretat (62%) e pjesëmarrësve që zgjedhin 10 (shumë të kënaqur) për pjesëmarrjen në këto. Po kështu, dobia e seancave të trajnimit për pjesëmarrësit në punën e përditshme ishte 9.4, mesatarisht, në një shkallë nga 1 në 10, dy të tretat e pjesëmarrësve që zgjedhin 10 (shumë të dobishme) informacionin që morën përmes këtyre seancave trajnuese.

Grafiku 1. Vlerësimi i përgjithshëm i trajnimit




Burimi i të dhënave: Analiza e Konsulentit bazuar në formularin e vlerësimit të kryer nën Komponentin 4

Pothuajse të gjitha seancat e trajnimit, pavarësisht nga tema u konsideruan shumë të rëndësishme nga pjesëmarrësit, të vlerësuar me rreth 4.7, mesatarisht, në një shkallë nga 1 (aspak e rëndësishme) në 5 (shumë e rëndësishme).

Sipas të dhënave të ilustruara në Grafikon 2:

- 7 në 10 pjesëmarrës i konsideruan shumë të rëndësishme (duke zgjedhur 5, në shkallën nga 1 në 5) seancat e trajnimit në lidhje me Inxhinierinë e Sigurisë Rrugore.
- 71% e pjesëmarrësve i konsideruan shumë të rëndësishme (duke zgjedhur 5, në shkallën nga 1 në 5) seancat e trajnimit në lidhje me Analizën e të Dhënave të Aksidenteve .
- 69% e pjesëmarrësve i konsideruan shumë të rëndësishme (duke zgjedhur 5, në shkallën nga 1 në 5) seancat e trajnimit në lidhje me Monitorimin dhe Vlerësimin e Sigurisë Rrugore.
- Dy të tretat e pjesëmarrësve (67%) i konsideruan shumë të rëndësishme (duke zgjedhur 5, në shkallën nga 1 në 5) seancat e trajnimit në lidhje me Menaxhimin e Sigurisë Rrugore, Legjislacionin, Financimin dhe Alokimin e Buxhetit.
- 64% e pjesëmarrësve i konsideruan shumë të rëndësishme (duke zgjedhur 5, në shkallën nga 1 në 5) seancat e trajnimit në lidhje me Fushatat e Publikimit dhe Ndërgjegjësimin të Sigurisë Rrugore dhe sondazheve të kryerjes për identifikimin e sjelljeve me rrezik të lartë të përdoruesve të rrugës.

Grafiku 2. Perceptimet dhe rëndësia e seancave të trajnimit



Burimi i të dhënave: Analiza e Konsulentit bazuar në formularin e vlerësimit të kryer nën Komponentin 4

Pavarësisht kushteve të veçanta të paraqitura nga pandemia, mënyra se si u organizuan seancat trajnuese përmbushën pritshmëritë e pjesëmarrësve. Aspektet në lidhje me organizimin e seancave të trajnimit të vlerësuara nga pjesëmarrësit, përmbajtja e seancave të trajnimit, organizimi, kohëzgjatja e seancave të trajnimit dhe përkthimi u konsideruan shumë të mira, 4.7, mesatarisht, në një shkallë nga 1 (shumë e dobët) në 5 (shumë mirë).


Rezultatet e vlerësimit treguan se (shih Grafikon 3):

77% e pjesëmarrësve e konsideruan shumë të mirë (duke zgjedhur 5, në shkallën nga 1 në 5) përkthimin e ofruar gjatë seancave të trajnimit.

73% e pjesëmarrësve thanë se mënyra e drejtimit të sesionit trajnues dhe përmbajtja e sesioneve të trajnimit ishin shumë të mira (zgjedhja e 5, në shkallën nga 1 në 5).

62% e pjesëmarrësve e konsideruan shumë të mirë ((duke zgjedhur 5, në shkallën nga 1 në 5) gjatësinë e secilës seancë trajnimi.

Grafiku 3. Perceptimet mbi cilësinë e aspekteve organizative



Burimi i të dhënave: Analiza e Konsulentit bazuar në formularin e vlerësimit të kryer nën Komponentin 4

Vlen të nënvizohet se asnjë pjesëmarrës nuk zgjodhi të vlerësojë më pak se mesatarja, më pak se 5 pikë nga 10, ose më pak se 3 pikë nga 5, aspektet nën shqyrtim, sipas të dhënave të ilustruara më lart.

3. Plani Punës

3.1 Ndjekja e komponenteve të aktivitetit

Component / Activity / Task			FEB	MAR	APR	MAY	JUN	JUN	JUL
Component 1 - Strengthen Road Safety Department as the Lead Office and the Secretariat of the IMRSC									
1.3.3	Prepare and conduct workshop on Legislation process	Capacity Development Workshop Report on Legislation process							X
1.4.3	Organize workshop on Funding and Resource Allocation	Capacity Development Workshop Report on Funding and Resource Allocation							X
1.5.2	Identify internal capacities for R&D in Albania	Capacity Needs Assessment Report on R&D in road safety							X
1.5.3	Propose R&D Plan	R&D road safety plan							X
1.6.1	Prepare and conduct formal training/workshops in targeted areas	Capacity Building Workshop Report on (i) road safety management, (ii) road infrastructure, (iii) vehicles, (iv) road users							X
1.6.2	Prepare and conduct on-the-job support and learning for creating a robust Lead office	Capacity Development Report on the implementation of the on-the-job support to the Lead Office							X
1.7.1f	Design and support project monitoring and evaluation systems for the high-risk corridors and areas (and control corridors and areas)	Capacity Development Report on "on-the-job support" for the baseline and ongoing data surveys							X
1.7.1g		Project Results indicators Review Report							X
1.7.2	Training Lead agency staff for monitoring and evaluation including ARA and Police and associated national consulting staff, and private institutes	Capacity Development Workshop Report on monitoring and evaluation							X
1.7.3	Evaluate the efficiency and effectiveness of the monitoring and evaluation systems in the high-risk corridors and areas (and control corridors and areas)	Monitoring and Evaluation System Review Report							X
1.7.4	Prepare (national) post-project program and guidelines for the establishment of a network-wide monitoring and evaluation system	Post-project, network-wide monitoring and evaluation program, incl. reviewed Guidelines							X
F.0.1	Produce Final Overall Project Report	Final Report (final version)							X

Gjatë periudhës Shkurt-Prill 2021, aktivitetet dhe detyrat e Komponentit 1 janë zbatuar në përputhje me planin e fundit të përditësuar të aktivitetit.

3.2 Plani i detajuar i aktiviteteve për tremujorin e ardhshëm

Detyra 1.5.3: Propozimi i Planit Kërkim & Zhvillim

- Propozimi për një Plan R&D afatshkurtër dhe afatmesëm për të mbështetur nevojat R&D në sigurinë rrugore në Shqipëri

Detyra 1.7.1: Mbështetja nga Njësia Drejtuese lidhur me “ Monitorimin dhe Zhvillimin”

- *Detyra 1.7.1f: Hartimi dhe mbështetja e sistemeve M&E të projektit për korridoret dhe zonat me rrezik të lartë (dhe kontrolli)*
- *Detyra 1.7.1g: Raporti i Shikimit të Treguesve të Rezultateve të Projektit*

Detyra 1.7.4: Përgatitja e programit (kombëtar) pas përfundimit të projektit dhe udhëzimet për krijimin e një sistemi monitorimi dhe vlerësimi në të gjithë rrjetin